

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Dragashit 2012

Gusht, 2012

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale dy vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”. Debatimi në “Jeta në Kosovë” për Komunën e Dragashit është transmetuar në RTK gjatë muajit gusht 2012.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Pesë problemet më të mëdha të identifikuara gjatë fushatës elektorale 2009...	4
1.1. Migrimi i popullatës .....	4
1.2. Mos integrimi i nxënësve goran në plan-programet mësimore të Kosovës.....	5
1.3. Mos subvencionimi i bujqësisë .....	5
1.4. Mungesa e ujit të pijshëm .....	6
1.5. Mungesa e transportit me Prizrenin .....	6
2. Performanca buxhetore e Komunës së Dragashit .....	7
2.1. Investimet kapitale.....	8
2.2. Menaxhimi me paranë publike .....	9
3. Arsimi .....	10
4. Shëndetësia .....	11
5. Administrata komunale .....	11
6. Transparenca .....	12
7. Puna e Kuvendit Komunal .....	12
8. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre .....	14
9. Burimet .....	17

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Dragashit, apo siç njihen në mesin e popullatës edhe si Komuna e Sharrit, është komuna më jugore e Kosovës. Kjo komunë shtrihet në lartësinë më të lartë mbidetare në Kosovë, rreth 1.500 metra. Kjo komunë vlerësohet ka 33.584 banorë, ku një e treta janë goran/boshnjak. Banorët e kësaj komune jetojnë në 36 fshatra, ku 18 fshatra janë të populluara me shqiptar kurse 18 janë të banuara me goran. Me gjithë popullatën e përzier, Komuna e Dragashit njihet për tolerancë ndëretnike. Megjithatë në këtë komunë shkollat punojnë me dy plan-programe, atë të Kosovës dhe atë të Serbisë, përderisa lirshëm veprojnë edhe strukturat paralele serbe.

Që nga viti 2007 Komuna e Dragashit qeveriset nga PDK-ja dhe kryetari i saj Salim Jonuzi. Ky është mandati i dytë me të cilin udhëheq Salim Jonuzi, i cili është në koalicion me VAKAT - parti përfaqësuese e komunitetit goran. Komuna e Dragashit konsiderohet ndër komunat më të pa zhvilluara në Kosovë. Edhe pse ka një terren shumë të përshtatshëm për zhvillimin e bujqësisë si dhe ka pamje të mira për zhvillimin e turizmit, Komuna asnjëherë nuk ka pasur një plan për zhvillimin e tyre. Në Komunën e Dragashit ndodhet edhe një humnerë e njohur si Shpella e Zgatarit, e cila konsiderohet si atraksion. Kjo 'shpellë' është një gropë e hapur me një thellësi mbi 60 metra ku nuk mund të zbritet e as të dilet. Aty kanë gjetur vdekjen shumë njerëz dhe kafshë. Aty çdo vit nxënësit dërgohen në shëtitje. Komuna kurrë nuk ka marrë asnjë iniciativë për vendosjen e shenjave paralajmëruese për rrezik, apo për rrethimin e kësaj grope në mënyrë që mos të ketë më viktima në njerëz dhe kafshë.

Komuna e Dragashit është ndër komunat me buxhet më të vogël, i cili sillet rreth 5.9 milion. Në dy vitet e kaluara një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është shfrytëzuar për ndërtimin e rrugëve. Për shkak të ekonomisë së dobët, shumë qytetar të kësaj komune kanë migruar dhe shumë fshatra rrezikojnë të boshatisen. Në anën tjetër Komuna ka vazhduar të asfaltojë rrugët e këtyre fshatrave pavarësisht numrit të vogël të banorëve.

Edhe Kryetari Jonuzi, sikurse disa homologë të tij, nuk ka arritur të shmangë mospërfshirjen në konteste gjyqësore. Ndaj Kryetarit të Komunës dhe kryesuesit të KK-së, Lulzim Rifaj është ngritë aktakuzë nga Prokuroria e Qarkut të Prizrenit për shpërdorim të pozitës zyrtare. Në aktakuzë thuhet se të akuzuarit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, i shkaktajnë dëme ndërmarrjes shoqërore Sharr Prodhimit në Dragash, me të cilën menaxhon AKP-ja. Kryetari Jonuzi ka urdhëruar drejtorin e urbanizmit kadastral që të bart pronën shoqërore në sipërfaqe prej 29.727 ha, prej pronarit të ndërmarrjes shoqërore Sharr Prodhimi në pronë të komunës së Dragashit. Pastaj këto patundshmëri u janë dhënë në shfrytëzim pa ndonjë bazë juridike personave fizik, blegtorëve. Seanca e parë gjyqësore është mbajtur me 20 mars 2012.

## 1. Pesë problemet më të mëdha të identifikuar gjatë fushatës elektorale 2009

Në prag të fushatës zgjedhore 2009, Instituti GAP kishte zhvilluar një anketë me banorët e komunës së Dragashit për të identifikuar pesë problemet kryesore me të cilat përballet kjo komunë.<sup>1</sup> Nga kjo anketë kishte rezultuar se pesë problemet më të mëdha të kësaj komune ishin:

1. Migrimi i popullatës
2. Mos integrimi i nxënësve goran në plan-programet mësimore të Kosovës
3. Mos subvencionimi i bujqësisë
4. Mungesa e ujit të pijshëm
5. Mungesa e transportit me Prizrenin.<sup>2</sup>

### 1.1. Migrimi i popullatës

Mos zhvillimi ekonomik i kësaj komune ka rezultuar në migrimin e vazhdueshëm të popullatës. Edhe pse qytetarët e komunës së Dragashit njihen për familje të shumta që jetojnë jashtë vendit, pas luftës migrimi i individëve dhe në shumë raste edhe i familjeve të tëra është shpeshtuar. Kjo dukuri është edhe më serioze në mesin e komunitetit goran të kësaj komune. Sa për ilustrim po përmendim faktin se vetëm nga fshati Lubovisht janë shpërngul më shumë se 10 familje vitet e fundit, kurse në fshatin Orqush kanë jetuar dikur 120 familje, ndërsa sot jetojnë diku rreth 40 banor. Një gjë e tillë ka ndodh edhe me disa familje nga fshati Krushë si dhe nga fshati Vranisht. Komuna nuk ka politika për parandalimin e migrimit. Megjithatë, mërgata mbetet njëri nga burimet e vetme financiare për shumë familje të Dragashit. Supozohet se rreth 40 për qind e popullatës jetojnë nga të afërmit e tyre që gjenden me punë jashtë vendit. Por kjo nuk justifikon trendin në rritje të migrimit, i cili vjen si pasojë e mungesës së politikave për parandalimin e migrimit.

Një problem tjetër i lidhur me migrimin është edhe projekti i paraparë për ndërtimin e Hidrocentralit të Zhurit, i cili parasheh zhvendosjen e disa shtëpive të fshatit Çellopek, Brezne dhe një pjese të fshatit Buçe. Edhe pse ky projekt zyrtarisht nuk ka nisur së implementuari nga Qeveria e Kosovës, qytetarët e këtyre fshatrave vazhdojnë të kenë mungesë të informatave të sakta se ku do të zhvendosën, si do të bëhet kompensimi i pronave të tyre, etj. Ndërtimi i hidrocentralit të Zhurit ka qenë premtim edhe i kryetarit

<sup>1</sup> Instituti GAP. "Dragashi – Raporti Komunal 2009. Nëntor 2009. Burimi:

[http://institutigap.org/repository/docs/Dragashi-raporti\\_komunal.pdf](http://institutigap.org/repository/docs/Dragashi-raporti_komunal.pdf)

<sup>2</sup> Gjatë intervistave me qytetarë, si probleme më madhore ishin potencuar problemet si: papunësia, rrjeti dobët i energjisë elektrike, varfëria, etj. Mirëpo në raportin e GAP të 2009 këto probleme nuk janë listuar për arsye se zgjidhja e këtyre problemeve nuk është kryesisht në kompetencë të kryetarit të komunës. Andaj në këtë listë prej pesë problemeve figurojnë vetëm ato probleme të cilat mund të zgjidhen me anë të punës së kryetarit të komunës.

të komunës, edhe pse kjo është nën kompetencat e ministrisë përkatëse. Në vitin 2009 Kuvendi komunal ka marr një vendim që ndalon ndërtimin e objekteve të reja në tri fshatrat që do të zhvendosen për shkak të hidrocentralit, në Qollopek, Brezne dhe Buqe. Por, banoret e këtyre fshatrave vazhdojnë të ndërtojnë shtëpi të reja, ku vetëm në Brezne gjatë vitit të kaluar janë ndërtuar 12 shtëpi të reja, dhe komuna nuk ka ndërmarrë asnjë masë për parandalimin e ndërtimit të shtëpive.

## **1.2. Mos integrimi i nxënësve goran në plan-programet mësimore të Kosovës**

Në disa shkolla të Komunës së Dragashit, në pjesën e Gorës, akoma punohet me plan-programe të Qeverisë së Serbisë. Plan-programet serbe aplikohen si në shkollat fillore ashtu edhe në atë të mesme. Nxënësit goran që më parë mësonin në gjimnazin e vetëm në komunë 'Fetah Sylejmani' (ish 'Nazim Berati') që gjendet në qytetin e Dragashit, tashmë janë larguar nga aty dhe mësojnë në gjimnazin e fshatit Mlik, ku aplikohet plan-programi serb. Aty dhe në të gjithë shkollat fillore në fshatrat Restelicë, Brod, Gllloboçic, Rapç, etj., mësuesit paguheshin nga buxheti i Serbisë. Deri në vitin 2009 rrogat e mësuesve silleshin nga 650 euro deri në 1.050 euro (për ata me fakultet) në muaj. Kjo ka qenë një nga arsyet që këto shkolla nuk kanë treguar ndonjë vullnet që të ndërpresin bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit të Serbisë dhe të aplikojnë plan-programin e shkollave të Kosovës. Deri më sot Komuna e Dragashit nuk ka arritur t'i integrojë nxënësit dhe arsimtarët goran në planprograme të Kosovës. Për më tepër, në Komunën e Dragashit vazhdon të jetë evident edhe ekzistimi i strukturave paralele serbe. Në fshatin Vraniq të Dragashit ndodhet administrata paralele Serbe e cila i kryen shërbimet për disa qytetar goran.

## **1.3. Mos subvencionimi i bujqësisë**

Toka e komunës së Dragashit është shumë e përshtatshme për kultivimin e disa perimeve, në veçanti patates. Edhe pse zhvillimi i bujqësisë duhej të ishte prioritet i secilit pushtet lokal në këtë komunë, nuk është vërejtur ndonjë strategji zhvillimore deri më tani. Përveç iniciativave individuale, kryesisht subvencioneve që ndanë Ministria e Bujqësisë për fermerë individual, komuna nuk ka arritur të dal me një plan se si ta zhvillojë bujqësinë dhe t'i shfrytëzojë tokat kolektive, sikurse atë të Mejdanit ku më parë është kultivuar gruri apo patatja. Kjo është një hapësirë e madhe prej 300 hektarësh që tash e sa vjet nuk shfrytëzohet. Vlen të cekët gjithashtu se territori i Dragashit është mjaft i përshtatshëm për rritjen e disa bimëve të rralla, siç është boronica. Vjelja e këtyre bimëve çdo vit bëhet nga kompani private të cilat stimulojnë qytetarët e kësaj komune të bëjnë vjeljen e tyre dhe ia shesin më pas këtyre kompanive.

## 1.4. Mungesa e ujit të pijshëm

Mungesa e ujit të pijshëm është preokupim i një pjese të qytetit të Dragashit. Uji bashkë me kanalizimin konsiderohen si dy probleme që kërkojnë zgjidhje, sidomos në qytetin e Dragashit. Megjithëse në territorin e Dragashit besohet se ekzistojnë burime të ujit, uji duhet të silllet nga distanca të largëta. Uji në qytetin e Dragashit nuk preferohet të pihet, sidomos gjatë reshjeve të shiut kur uji bëhet tejet i ndotur. Kanalizimi ka qenë problem madhor për disa fshatra. Ky problem në masë të madhe është tejkaluar pasi gjatë vitit 2011 Komuna ka investuar në disa fshatra për shtrimin e rrjetit të kanalizimit, sikurse në fshatin Kosavë, Kuk dhe Kuklibeg.

## 1.5. Mungesa e transportit me Prizrenin

Pasi që Dragashi është komuna më jugore e Kosovës, si qendër më të afërt zhvillimore kjo komunë ka qytetin e Prizrenit. Por, mungesa e shpeshtë e transportit me Prizren pamundëson lëvizjen e shpeshtë të qytetarëve të Dragashit dhe banorëve të Gorës. Qyteti i Dragashit është 37 kilometra larg Prizrenit, por transportit publik (autobusët) që lidhin këtë relacion janë shumë të rrallë. Përveç transportit privat, qytetarëve iu duhet të presin me orë të tëra për autobusin e radhës për në Prizren. Në anën tjetër qytetarët e Dragashit dhe rrethit të Gorës shpesh detyrohen të udhëtojnë prej Prizrenit deri në vendin e quajtur Tyrbe, me autobusë që shkojnë për në fshatrat e Opojës e që janë më të shpeshtë se sa autobusët që shkojnë për Dragash. Gjatë fushatës zgjedhore Z. Salim Jonuzi kishte premtuar linja më të shpeshta Dragash-Prizren. Kjo edhe është arritur deri diku pasi se Komuna ka kontraktuar kompaninë turistike ERZA nga fshati Blaq që të mbajë linjë të rregullt Dragash-Prizren dy herë në dite. Kjo i kushton buxhetit të komunës 60.000 euro në vit. Të liruar nga pagesa janë invalidët e luftës, përfituesit e ndihmave sociale dhe pensionistet, por jo edhe studentët.

Nxënësit e shkollave të mesme që udhëtojnë nga fshatrat e Opojës për në Dragash detyrohet që të paguajnë vetë transportin, i cili kryhet përmes autobusëve dhe kombibusëve privat. Kështu Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë për sigurimin e transportit për nxënësit e shkollave të mesme. Mungesa e transportit është e dukshme edhe tek nxënësit e shkollave fillore që udhëtojnë nga fshati Buzes në fshatin Bresanë nëpër magjistralen që lidh këto dy fshatra e cila frekuentohet shumë nga automjetet. Nxënësit e fshatit Pllajnik detyrohen të udhëtojnë në fshatin Kosavë edhe në kushte të vështira të dimrit. Rrezikut të komunikacionit i nënshtrohen edhe nxënësit që udhëtojnë nga fshatrat Rrencë-Pllavë-Llapushnik. Mungesa e transportit jo vetëm që rrezikon jetën e këtyre filloristëve por bën që disa nga ta të braktisin shkollën shumë më herët.

## 2. Performanca buxhetore e Komunës së Dragashit

Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2011 ka qenë 5,969,436 euro,<sup>3</sup> prej të cilave 87.3% ishin nga granti i përgjithshëm qeveritar. Të hyrat vetanake 2011 ishin 391.715 euro, kurse grantet e jashtme (nga donatorët) ishin 247.158 euro. Grantet e donatorëve kanë ndihmuar në realizimin e disa projekteve të premtuara nga kryetari Jonuzi, sikurse ndërtimi i Tregut të Gjelbërt në Dragash. Për këtë projekt Komuna e Dragashit ka përfituar një grant prej 168.829 euro. Megjithëse është ndërtuar, Komuna, të paktën deri në korrik 2012, nuk ka qenë në gjendje ta vejë në funksion këtë treg për shkak të disa procedurave menaxhuese. Edhe nga UNDP Komuna ka përfituar grant prej 90.000 euro, të cilat i ka shfrytëzuar mes tjerash edhe për rehabilitimin e bibliotekës në Bellobrad, ndërtimin e oborrit të shkollës në Brrut dhe pastrimin e mbeturinave në Restelicë.

Shpenzimet totale për mallra dhe shërbime për vitin 2011 kanë qenë më të larta se viti paraprak për 12.29%. Gjate vitit 2011 shpenzimet për telefon mobil kanë qene 16.685 euro, që është një shumë më e madhe se sa për vitin 2010 që ishte 13.673 euro. Ndërkaq për karburant për vetura janë shpenzuar 57.345 euro, kurse për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve 17.701 euro. Kurse për dreka zyrtare gjatë vitit 2011 janë shpenzuar 10.210 euro, që është më e ulët se sa në vitin 2010 kur ishte 19.244 euro. Komuna e Dragashit ka përmbyllur vitin 2011 me 24 mijë euro borxh ndaj furnitorëve. Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin fiskal 2012.

Komuna e Dragashit në dy vitet e kaluara (2010-2011) ka lidhur tri kontrata të ndryshme për servisimin e automjeteve të komunës (veturat e komunës, veturat e QMF, veturat e Qendrës për Punë Sociale) dhe vlera e këtyre servisimeve ka kushtuar mbi 901 mijë euro. Për servisimin e automjeteve Komuna e Dragashit me datë 22.12.2011 ka dhenë kontratë në vlerë prej **175.682 eurove**. Kontrata është nënshkruar me kompaninë "Flamuri" nga Suhareka. Për servisim të automjeteve po ashtu Komuna e Dragashit ka lidhur kontratë me datë 15.11.2011 në vlerë të kontratës **267.105 eurove**. Kontrata është lidhur me kompaninë "LML Prizren". Po për servisimin e veturave Komuna e Dragashit me datë 07.09.2010 ka lidhur kontratë me vlerë prej **458.736 eurove**. Kontrata është lidhur me kompaninë "Euro Food -Remont Servis" Prizren. Këto janë mjete të kontraktuara dhe jo domosdoshmërisht të gjitha të shpenzuara.

Komuna nuk është treguar shumë e suksesshme në rritjen e të hyrave vetanake. Për shembull, fabrika REMATEX e cila gjendet në Dragash dhe është në shfrytëzim te investitorëve turq, i ka borxh komunës mbi 120.000 euro të tatimit në pronë. Komuna nuk është treguar e afte për mbledhjen e kësaj shume. Komuna nuk i ka bërë shumë presion fabrikës RAMATEX për pagesën e tatimit në pronë pasi se fabrika ka punësuar rreth 400 punëtor. Kryetari Jonuzi në fushatën zgjedhore kishte premtuar hapjen e 500 vendeve të punës. Kështu Kryetari i Komunës e konsideron si të arritur të tij këtë zbutje

<sup>3</sup> Komuna e Drgashit. Raporti mbi realizimin e buxhetit për vitin 2011.



të papunësisë në komunë. Të hyrat vetanake të komunës për vitin 2011 nga tatimi në pronë kanë qenë 101.432 euro, kurse vetëm RAMATEX supozohet se i ka borxh rreth 120.000 euro.

## 2.1. Investimet kapitale

Nga buxheti i Komunës për vitin 2011, për investime kapitale janë shpenzuar gjithsej 1.977.693 euro, prej të cilave:

- 1.146.771 euro për rrugë,
- 381.443 euro për ujësjellës,
- 156.974 euro për objekte arsimore,
- 49.263 euro për objekte shëndetësore, etj.

Duhet cekur se ndërtimi i rrugëve lokale merr pjesën më të madhe të buxhetit për investime kapitale që nga viti 2009. Për rrugë në vitin 2011 u shpenzuan 1.146.771 euro, më 2010 u shpenzuan 1.102.554 euro, dhe më 2009 u shpenzuan 726.658 euro.

Edhe pse për ndërtimin e rrugëve lokale në vitin 2011 janë shpenzuar mbi 1.1 milion euro, megjithatë kualiteti i rrugëve në disa vende është shumë i dobët. Pothuajse për çdo vit komuna duhet të riparojë rrugën Trekon-Dragash. Po ashtu rruga në 'Mejdan' është në gjendje shumë të keqe pasi se janë hapur gropa të shumta. Megjithëse në Komunën e Dragashit ka shumë të reshura dhe asfalti mund të priset shpejt, Komuna nuk ka marrë masa që cilësia e punimeve të jetë më e lartë. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për investime kapitale është shfrytëzuar edhe për kubëzimin e disa lagjeve nëpër fshatra të Dragashit. Megjithatë, në shumë fshatra të Dragashit vërehen kubëzime të pjesshme të rrugëve, ku janë shtruar disa metra rrugë me kubëza në një lagje dhe disa metra në një lagje tjetër, duke mos e kompletuar asnjërin rrugë si duhet. Qytetarët e Dragashit shprehen se kjo është një taktikë e Komunës për t'i bindur qytetarët se po investojmë në të gjithë fshatrat dhe në të gjitha lagjet e fshatrave, pavarësisht punëve gjysmake që po bën komuna.

Megjithatë, të dhënat tregojnë se ka një disproporcion në ndarjen e buxhetit për investime kapitale nëpër fshatrat e Komunës. Në disa fshatra me më pak banorë është investuar më shumë se sa në ato me më shumë banorë, sikurse që është rasti me fshatin Zlipotok ku janë investuar 125.259 euro apo në Leshan ku janë investuar 219.776 euro gjatë vitit 2011. Në anën tjetër, në dy fshatrat me popullatë më të madhe, si Restelica dhe Bresana, në total janë bërë investime përgjysmë më pak (në fshatin Bresanë janë investuar 113.031 euro, në fshatin Restelicë janë investuar 148.082 euro). Fshati që me se paku është investuar gjatë vitit 2011 është fshati Zaplluxhe, me vetëm 20.000 euro.



Tabela nr.1: Disa nga investimet kapitale 2011 në Komunën e Dragashit

Viti	Projekti	Shuma (euro)
2011	Ndërtimi i ujësjellësit Dragash	270.000
2011	Asfaltimi i rrugës Qendra e Biznesit	200.000
2011	Asfaltimi i rrugës Leshtan	180.000
2011	Vazhdim i asfaltimit të rrugës Zlipotok	100.000
2011	Kubëzimi i rrugës Zgatar-Brrut	60.000
2011	Renovimi i shkollës fillore Restelicë	48.011
2011	Nxehja qendrore në shkollë - Bresanë	30.773
2011	Nxehja qendrore në shkollën e mesme	41.713

## 2.2. Menaxhimi me paranë publike

Raporti për Komunën e Dragashit i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm 2010, thotë se Komuna nuk i ka të regjistruara pronat, pajisjet dhe impiantet që janë në posedim të Komunës. Mos regjistrimi i pronave të patundshme mund të çoj deri te keqpërdorimi i tyre.<sup>4</sup> Bazuar në dëshmitë e mbajtura nga nëpunësi përgjegjës lidhur me kilometrat dhe vlerën e litrave të karburantit në vetura, është identifikuar që harxhimi i karburantit i disa veturave është më shumë se 20 litra për njëqind metra.<sup>5</sup> Shpenzimet për mëditje në vlerë prej 255 euro dhe 167,20 euro janë paguar për udhëtime biznesore për pjesëmarrje në Seminare të mbajtura në Mal të Zi (Budva) dhe Gjermani. Për këto shpenzime të paguara nuk ka pasur dëshmi të bashkangjitur për agjendën e seminareve, as aprovim të shkruar për pjesëmarrësit që kanë qenë prezent në këto seminare.

Auditorët e vitit 2010 i kishin bërë komunës pesë rekomandime kryesore, prej të cilave vetëm një është zgjidhur pjesërisht gjatë vitit 2011. Ndërkaq, në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011 janë gjetur mangësi në sistemin e kontabilitetit dhe faturimit, me ç'rast i është rekomanduar Kryetarit që Komuna të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyre që të sigurojë kontrolle të sigurta, eficientë dhe efektive në faturim dhe të hyra.<sup>6</sup> Defekte janë gjetur edhe për sa i përket prokurimit me ç'rast procedurat e prokurimit nuk janë bërë sipas Ligjit për Prokurim Publik në këto raste: bërjen e furnizimeve për zyre, mirëmbajtjen e veturave,

<sup>4</sup> Raporti për Dragashin nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 2010 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Dragashi\\_31.12.2010\\_shqip\\_200071.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Dragashi_31.12.2010_shqip_200071.pdf)

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Raporti për Dragashin nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 2011 [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Dragash\\_ALB\\_459496.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Dragash_ALB_459496.pdf)

naftë për ngrohje, furnizimi me dru për ngrohje, për ndërtimin e ujësjellësit, etj.

Tabela nr.2: Shpenzimet e Komunës së Dragashit 2011

Kategoria	Shuma (Euro)
Shpenzimet për internet	382
Shpenzimet e telefonisë mobile	16.685
Shpenzimet postare	645
Derivate për gjenerator	255
Karburant për vetura	57.345
Dreka zyrtare	10.210
Udhëtime në vend	12.838
Udhëtime jashtë vendit	2.440
Furnizimi me ushqim e pije	9.966
Karburant për ngrohje	117.510
Dru	50.967

### 3. Arsimi

Dragashi është ndoshta është një ndër qytetet e pakta në Kosovë që nuk ka as çerdhe publike dhe as private. Komuna nuk ka marrë asnjë iniciativë për ndërtimin e një çerdhe. Shumë nëna që punojnë e kanë të vështirë të gjejnë dikë për tu kujdesur për fëmijët e vegjël gjatë orarit të punës. Komuna e Dragashit ka gjithsej 15 objekte për parashkollorët, kurse numri i përgjithshëm i fëmijëve në arsimin parashkollor për vitin 2011/2012 ishte 306. Dragashi ka 18 edukatorë që kujdesen për këta fëmijë, që mesatarisht i bie një edukator për 17 fëmijë. Numri i edukatorëve është dukshëm më i vogël se sa në disa komuna të tjera që kanë numër të ngjashëm të parashkollorëve, si për shembull Vushtrria që ka 17 edukatorë për 186 parashkollorë, apo Ranillugu që ka 19 edukatorë për 210 fëmijë.<sup>7</sup>

Komuna e Dragashit ka 35 shkolla për nivelin arsimor të arsimit fillor dhe arsimit të ulët të mesëm. Në këtë nivel të arsimit, Komuna e Dragashit gjatë vitit 2011/2012 kishte gjithsejtë 4.333 nxënës dhe 367 mësimdhënës, me një përpjesëtim prej 11 nxënësish për një mësimdhënës. Sa i përket arsimit të mesëm të lartë, Komuna e Dragashit ka vetëm 1 shkollë të mesme (duke mos llogaritur këtu edhe gjimnazin paralel serb në fshatin Mlik) me 964 nxënës dhe 80 mësimdhënës.<sup>8</sup> Edhe pse ka një numër të madh të studentëve të cilët studiojnë në Prishtinë dhe Prizren, Komuna e Dragashit është ndër komunat e

<sup>7</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit për Çerdhe dhe Parashkollorë 2011/2012

<sup>8</sup> Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011/2012

pakta të Kosovës e cila nuk ka një fond për bursa për studentët.

Ndërrimi i drejtorëve të shkollave fillore ka qenë evident gjatë mandatit të z. Jonuzit. Ka pasur shkarkime dhe emërimë të drejtorëve, duke i ndërruar ata të partive të tjera me ata të PDK-së. Gjithashtu ka pasur edhe punësime të anëtarëve të PDK-së si mësimdhënës në shkollën e mesme të Dragashit, si dhe largime të arsimtarëve me përvojë të cilët i takonin partive të tjera.

Mos shpallja e konkurseve për vendet e lira në arsim është një problem që i preokupon shumë të diplomuar të papunë të kësaj komune. Shumë arsimtar të rinj janë punësuar pa konkurs, të cilët janë kryesisht anëtarë të partisë qeverisëse. Kësisoj përgatitja e tyre profesionale ngre shumë dilema, kurse në anën tjetër kjo dukuri e punësimit i dëmton kandidatët tjerë potencial.

#### **4. Shëndetësia**

Në shërbimin primar mjekësor në Komunën e Dragashit janë të punësuar 99 persona, prej të cilëve 22 janë mjekë. Në këtë Komunë funksionon Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, 5 Qendra të Mjekësisë Familjare dhe 7 ambulanca shëndetësore. Kryetari Jonuzi kishte premtuar vënien në funksion të disa punkteve shëndetësore, disa prej të cilave do të punonin 24 orë. Sot as edhe një ambulancë e vetme nuk punon 24 orë në këtë komunë. Ambulanca në Restelic punon deri në ora 2 pasdite. Ambulanca e Bredosanës punon në dy ndërrime, por jo 24 orë. Në ambulancën e fshatit Kuk mjeku nuk shkon asnjëherë, kurse ambulanca në Llapushnik ka mungesë të barërave esenciale. Ambulancat kanë pasur probleme edhe me mungesë të ngrohjes gjatë dimrit. Në ambulancën e fshatit Restelicë në mungesë të druve janë detyruar fshatarët që me krahë të dërgojnë dru nga shtëpitë e tyre. Duke e ditur se Dragashi ballafaqohet me dimra të ashpër dhe të gjatë, prapë se prapë Komuna nuk kalkulon si duhet furnizimin me dru të institucioneve të tilla publike.

#### **5. Administrata komunale**

Numri total i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Dragashit është 731, këtu duke përfshirë të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Ky numër është ngritur vetëm për 10 persona që nga viti 2009 kur numri total i punonjësve në sektorin publik ishte 721. Kjo Komunë ka gjithsej 8 drejtorë, por asnjëra nga to nuk udhëhiqet nga një femër. Numri i stafit komunalë është 117, kurse në zyrën e kryetarit punojnë gjithsej 12 persona.

## 6. Transparenca

Uebfaqja e Komunës së Dragashit është tejet e varfër me informacione. Aty ndodhet vetëm një raport i Kryetarit për realizimin e buxhetit janar-qershor 2010, kurse raportet vjetore nuk figurojnë askund. Në anën tjetër as edhe një procesverbal i vetëm i seancave të Kuvendit Komunal nuk është publikuar në uebfaqe. Në përgjithësi, Komuna e Dragashit është ndër komunat me uebfaqën më të varfër sa i përket informacioneve. Megjithatë, në kërkesat për qasje në dokumente publike vërehet një përgjegjshmëri më e lartë e komunës.

## 7. Puna e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal i Dragashit përbëhet prej 27 anëtarëve, të cilët përfaqësojnë gjithsejtë tetë subjekte politike. PDK dhe LDK kanë numër të njëjtë të anëtarëve, të pasuar nga partitë tjera shqiptare dhe gorane. Tabela në vazhdim pasqyron ndarjen e ulëseve në Kuvendin Komunal.

Tabela nr.3: Përbërja e Kuvendit Komunal të Dragashit 2009-2013

Partia	Nr. i anëtarëve
PDK	9
LDK	9
VAKAT	3
AAK	2
SDA	1
AKR	1
LDD	1
GIG	1

Gjatë vitit 2011 Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsejtë 13 mbledhje, 10 të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme, që do të thotë se kjo komunë i ka përmbushur obligimet ligjore. Edhe komitetet obligative kanë qenë funksionale, ku Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 9 mbledhje kurse ai për Komunitete ka mbajtur 8 sosh. Gjatë një viti Kuvendi Komunal ka miratuar 8 vendime dhe 1 rregullore. Gjatë vitit 2011 Kuvendi Komunal ka miratuar edhe Planin Lokal të Veprimit për Biodiversitetin e Komunës së Dragashit 2011-2015.<sup>9</sup> Me rastin e themelimit të grupit punues për hartimin e këtij Plani, Kuvendi i Komunës ka bërë shkelje ligjore, pasi që nuk e ka respektuar kuotën e përfaqësimit gjinor në këtë grup.<sup>10</sup> Një draft të këtij Plani qytetarët mund ta gjejnë edhe në uebfaqen e komunës, por jo edhe Planin final. Ndërkaq, Kryetari i Komunës gjatë

<sup>9</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – Raporti i Monitorimit të Komunave të Kosovës 2011.

<sup>10</sup> Po aty.

vitit 2011 ka mbajtur dy takime publike me qytetarët dhe ka raportuar dy herë para anëtarëve të Kuvendit.

Për shkak se asambleja komunale është e përbërë prej dy etnitetëve shqiptar dhe goran, kërkohet përkthim simultant në çdo seancë të kuvendit. Por, për katër muaj (të paktën nga janari deri në prill 2012) nuk kanë funksionuar pajisjet për përkthim. Kështu që 50% e asamblistëve nuk e kanë kuptuar se për çka po flitet anë seancë. Gjithashtu në sallën e seancave të Kuvendit të Komunës gjatë gjithë kohës së dimrit këshilltarët janë ballafaquar me të ftohtin për shkak se ka munguar ngrohja qendrore. Ata kanë qëndruar në sallë me pallto të dimrit. Në anën tjetër gjatë dimrit nga shkolla fillore e fshatit Blaq janë marrë tre kamion me thëngjill dhe i janë dërguar fabrikës IT Rematex në Dragash. Mbetet e pa qartë kush ka lejuar dhe me çfarë të drejte i është dhënë thëngjilli i shkollës një fabrike private.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Procesverbali i seancës së Kuvendit Komunal me datë: 22.02.2012

## 8. Premtimet zgjedhore dhe realizueshmëria e tyre

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune për mandat të dytë, tani kryetari i Komunës z. Salim Jonuzi (PDK), elektoratit i kishte prezantuar një program zhvillimor dhe me shumë premtime. Pas regjistrimit të të gjitha premtimeve të bëra gjatë fushata zgjedhore, më 2010 Instituti GAP dhe BIRN i patën shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës së Dragashit z. Jonuzit, ku ia patën përkujtuar edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizueshmërinë e tyre (Letra e GAP dhe BIRN: Instituti GAP dhe BIRN. Letër e hapur Kryetarit të Komunës së

Dragashit z. Salim Jonuzit. Maj 2010. Burimi: <http://institutigap.org/repository/docs/LeterDragash.pdf>

Tabela më poshtë mat progresin e arritur në realizueshmërinë e premtimeve të dhëna në 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 18 premtime të dhëna nga kryetari Jonuzi. Disa nga to janë përmbushur, disa vetëm pjesërisht, e disa ende nuk janë përmbushur. Disa prej premtimeve janë jorealiste sepse nuk janë në kompetencë të Kryetarit të Komunës.

Premtimet e dhëna	Ecuria e realizimit
Ndërtimi i shkollave të reja dhe pajisjen e shkollave me kabinete	Deri me tani nuk është ndërtuar asnjë shkollë e re. Në buxhetin e vitit 2012 është parapare edhe ndërtimi i shkollës 9 vjeçare në Bellobrad dhe renovimi i shkollës fillore në Zlipotok.
Ndërtimin e godinës së shkollës së mesme profesionale në vlerë prej 2 milion euro	Kjo shkollë ka nisur së ndërtuari në vitin 2010. Por, nuk dihet se kur do të mbarojë ndërtimi i saj
Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë	Nuk vërehet ndonjë ngritje e cilësisë në arsim dhe shëndetësi. Përkundrazi zëvendësimi i arsimtarëve me përvojë me të posadiplomuar, ngre shqetësime për cilësinë e arsimit që mund tu ofrohet.
Pajisjen e QMF-ve me barna të nevojshme	Në shumicën e QMF-ve vazhdon të ketë mungesë të barërave esenciale. Qytetarët detyrohen të blejnë barëra në barnatoret private që ndodhën pranë ambulantave.

Vënie në funksion të disa punkteve shëndetësore, disa prej të cilave do të punojnë 24 orë, si në Bredosan, Restelicë, etj.	As edhe një ambulancë e vetme nuk punon 24 orë në këtë komunë. Ambulanca në Restelicë punon deri në ora 2 pasdite. Ambulanca e Bredosanës punon me dy nderrime, por jo 24 orë. Në ambulancën e fshatit Kuk mjeku nuk shkon asnjëherë. Ambulanca në Llapushnik ka mungesë të barërave esenciale.
Asfaltimin e rrugëve të çdo lokaliteti të komunës	Shumica e rrugëve janë asfaltuar dhe janë kubëzuar, por jo edhe të çdo lagjeje. Ende ka rrugë të pa kubëzuara nëpër shumë fshatra.
Asfaltimin e rrugës Zaplluxhe-Tetovë	Asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.
Ndërtimin e rrugës Restelicë- Mavrovë	Asgjë nuk është bërë në këtë drejtim.
Ujësjetësin dhe kanalizimin nëpër të gjitha fshatrat	Në disa fshatra është bërë kanalizimi mirëpo cilësia e punimeve mbetet problematike. Megjithatë, ka fshatra që nuk e kanë të rregulluar punën e kanalizimit. Vetë qyteti i Dragashit ballafaqohet me problem të ujit të pijshëm, sidomos gjatë reshjeve të shiut uji ndotet shumë.
Fillimin e ndërtimit të hidrocentralit të Zhurit	Asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Madje fshatrat që do të zhvendosën nuk kanë asnjë informacion zyrtar se si do të zhvendosën, çfarë do të ndodhë me pronat e tyre, etj. Ata mbahen vetëm me thashetheme.
Hapjen e 500 vendeve të reja të punës	Rreth 400 persona janë punësuar në fabrikën RAMATEX, dhe shumica e tyre janë punësuar para këtij mandati. RAMATEX është firmë private dhe punësimi i tyre nuk është meritë direkte e Kryetarit.
Ndërtimin e qendrës së biznesit	Është punuar, por ende nuk është kompletuar ndërtimi i qendrës së biznesit pasi se ka mungesë të ujit, rrymës dhe kanalizimit. Qendra nuk ka



	një trafo të veçantë vetëm për bizneset. Megjithatë dy biznese i kanë ndërtuar objektet e tyre.
Vendosjen e tregut në një vend të caktuar	Tregu i ri është ndërtuar por ende nuk është zhvendosur për shkak të disa procedurave menaxhuese. Financimi i tregut ka qenë donacion i Komisionit Evropian.
Linja më të shpeshta të autobusëve Dragash-Prizren	Komuna ka kontraktuar kompaninë turistike ERZA nga fshati Blaq që të mbajë linjë të rregullt Dragash-Prizren dy herë në dite. Kjo i kushton buxhetit të komunës 60.000 euro në vit. Të liruar nga pagesa janë invalidët e luftës, përfituesit e ndihmave sociale dhe pensionistet, por jo edhe studentet.
Hapjen e rrugëve nëpër kullota dhe ndërtimin e lugjeve për pije	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.
Ndërtimin e hallës sportive me kapacitet 1.500 shikues, që do të kushton 800.000 euro	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.
Ndërtimin e terreneve të hapura sportive (brenda 2 viteve)	Nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.
Përkrahjen për krijimin e klubeve futbollistike	Nuk ka pasur ndonjë iniciativë në këtë drejtim. Komuna e Dragashit mbetet komuna më pasive sa i përket aktiviteteve sportive. Në këtë komunë nuk zhvillohen gara në futbollë dhe nuk ekziston as klubi futbollistik i Dragashit.

## 9. Burimet

1. Procesverbali i seancës së tretë të Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 21.03.2012
2. Procesverbali i seancës së Kuvendit Komunal me datë: 22.02.2012
3. Instituti GAP. "Dragashi - Raporti Komunal 2009, nëntor 2009
4. Raporti mbi realizimin e buxhetit për vitin 2011, Komuna e Dragashit
5. Raporti për Dragashin nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 2010
6. Raporti për Dragashin nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 2011
7. Agjencia kundër korrupsionit - Deklarimi i Pasurisë 2012
8. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Arsimit për Çerdhe dhe Parashkollorë 2011/2012.
9. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011/2012.
10. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - Raporti i Monitorimit të Komunave të Kosovës 2011.
11. Njoftimet e Komunës së Dragashit të shpallura nga Komisioni Rregullativ i Prokurorit Publik për periudhën janar 2010 - qershor 2012.
12. Intervista me përfaqësuesit e opozitës, medieve dhe shoqërisë civile, të zhvilluara në periudhën maj-qershor 2012.